

Vendim nr. 156 datë 04.07.2024

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, i përbërë nga:

Fiona Papajorgji,	Kryesuese
Illir Toska,	Anëtar
Sandër Beci,	Anëtar

në datën 04.07.2024 mori në shqyrtim paraprak kërkesën nr. 7 (F) 2024 të Regjistrimit Themeltar, që i përket:

KËRKUESE: **FLORIANA PASKALI**

OBJEKTI: Shfuqizimi i vendimeve nr. 3028, datë 04.03.2014 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë; nr. 1613, datë 26.06.2015 të Gjykatës së Apelit Tiranë; nr. 00-2023-5459, datë 22.12.2023 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë (dhomë këshillimi), si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.

BAZA LIGJORE: Nenet 42, 43, 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pika 1, shkronja “i”, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë (*Kushtetuta*); neni 6 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (*KEDNJ*) dhe neni 1 i Protokollit nr. 1 të saj; ligji nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar (*ligji nr. 8577/2000*).

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese (*Kolegji*), pasi dëgjoi relatorin e çështjes Sandër Beci, shqyrtoi kërkesën, dokumentet shoqëruese, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I

Rrethanat e çështjes

1. Kërkuësja Floriana Paskali (*kërkuësja*) është një nga trashëgimtarët e radhës së parë të trashëgimlënësit, babait të saj O.P. Ky i fundit ka blerë nga shtetasi A.K. një truall me sipërfaqe *aproximative* 690 m², me kufij të përcaktuar, të ndodhur në Tiranë, me kontratën e shitblerjes me nr. 1861/8874, datë 16.01.1961 (*kontrata e shitblerjes e vitit 1961*), kontratë të cilën e ka regjistruar në regjistrat hipotekarë të kohës. Ndërkohë, në vitin 1993, trashëgimtarët e O.P. i janë drejtuar gjykatës me kërkesë për vërtetimin në rrugë gjyqësore të faktit se sipërfaqja e truallit të blerë nga ai në vitin 1961 është 1014,8 m². Me vendimin nr. 4080, datë 29.11.1993, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë ka vendosur pranimin e kërkesës dhe saktësimin e sipërfaqes së truallit të blerë nga trashëgimlënësi O.P. sipas kontratës së shitblerjes së vitit 1961. Edhe ky vendim gjyqësor është regjistruar në regjistrat hipotekarë të kohës.

2. Nga ana tjetër, shtetasi K.B. ka blerë nga Komiteti Ekzekutiv i Rajonit nr. 1, Tiranë, një truall me sipërfaqe 420 m², me kufij të përcaktuar, të ndodhur në Tiranë, me kontratën e shitblerjes me nr. 683 kol., dhe nr. 1803 rep., datë 09.07.1992 (*kontrata e shitblerjes e vitit 1992*), kontratë të cilën e ka regjistruar në regjistrat hipotekarë të kohës me nr. 2189, datë 09.07.1992. Në vijim, shtetasi K.B. është pajisur me leje ndërtimi dhe në truallin e blerë ka ndërtuar një shtëpi 3-katëshe.

3. Në datën 23.05.2012 kërkuësja ka vënë në lëvizje një proces gjyqësor me anë të një padie për kërkimin e trashëgimit, duke kërkuar njohjen trashëgimtar ligjor të të ndjerit O.P., njohjen e së drejtës së pronësisë, kërkimin dhe dorëzimin e pasurisë trashëgimore truall me sipërfaqe 420 m², të ndodhur në Tiranë, me kufij të përcaktuar; deklarimin e pavlefshëm të veprimit juridik, kontratës së shitblerjes të vitit 1992; lirimin dhe dorëzimin e truallit; fshirjen e regjistrimit hipotekar nr. 2189, datë 09.07.1992 dhe çdo regjistrimi tjetër për këtë pasuri. Kërkuësja ka pretenduar se është trashëgimtare ligjore e babait të saj nga trashëgimia e të cilit ka fituar pronësinë për një truall me sipërfaqe 1014,8 m², një pjesë e të cilit është edhe sipërfaqja 420 m², që posedohet nga shtetasi K.B. dhe se kontrata shitblerjes e vitit 1992 është absolutisht e pavlefshme për shkak se Komiteti Ekzekutiv i Rajonit nr. 1, Tiranë ka shitur një truall që nuk ka qenë në pronësi të shtetit, por në pronësi të trashëgimlënësit të saj.

4. Në përfundim të gjykimit, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr. 3028, datë 04.03.2014, ka vendosur rrëzimin e padisë si “gjë të gjykuar” në aspektin material, në kuptim të përcaktimeve të nenit 451/a të Kodit të Procedurës Civile (*KPC*). Sipas gjykatës, kërkimet në padi dhe pretendimet e kërkuësës si trashëgimtare e O.P. janë të njëjta me ato të

padisë së trashëgimtarit tjetër të tij, shtetasit Th.P., padia e të cilit është rrëzuar me vendimin nr. 3580, datë 06.06.2005 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë (*vendimi nr. 3580/2005*), i cili është lënë në fuqi nga Gjykata e Apelit Tiranë me vendimin nr. 771, datë 21.06.2006, ndërsa Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë ka vendosur mospranimin e rekursit të tij.

5. Pas ankimit të kërkueses, Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin nr.1613, datë 26.06.2015, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të gjykatës së shkallës së parë, kurse Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, në dhomën e këshillimit, me vendimin nr. 00-2023-5459, datë 22.12.2023, ka vendosur mospranimin e rekursit të saj.

6. Kërkuësja në datën 22.04.2024 (*data e shërbimit postar*) i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (*Gjykata*) me ankim kushtetues individual sipas objektit, i cili është regjistruar përfundimisht në datën 03.05.2024 pas plotësimit të dokumenteve.

II

Pretendimet e kërkueses

7. **Kërkuësja**, në mënyrë të përmbledhur, ka pretenduar se i është cenuar:

7.1. *E drejta e aksesit*, pasi Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, megjithëse ishin parashtruar shkelje të ligjit material dhe procedural, nuk i ka përmendur ose nuk i ka dhënë përgjigje atyre. Në pjesën hyrëse të vendimit nuk gjejnë pasqyrim në mënyrë të përmbledhur të gjitha shkaqet e rekursit. Nëse Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë do t'i kishte marrë në shqyrtim të gjitha shkaqet e rekursit dhe do t'i shqyrtonte, do të kishte arritur në një përfundim të ndryshëm.

7.2. *Parimi i paanshmërisë*, pasi të tria gjykatat e juridiksionit të zakonshëm kanë marrë në konsideratë vetëm prapësimet e palës së paditur, ndërsa pretendimet dhe kërkimet faktike e ligjore të kërkueses janë kaluar në heshtje ose përciptazi.

7.3. *Parimi i barazisë së armëve dhe kontradiktoritetit*, pasi çështja nuk është gjykuar në themel, por vetëm nga pikëpamja procedurale është arritur në përfundimin se është gjë e gjykuar.

7.4. *Standardi i arsytimit të vendimit gjyqësor*, pasi vendimet e të gjitha gjykatave nuk janë arsyetuar në pajtim me kërkesat procedurale të dispozitave kushtetuese dhe ligjore, me jurisprudencën e Gjykatës dhe të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Për një çështje kaq komplekse dhe të patrajtuar në praktikën gjyqësore duhej një arsyetim i gjerë dhe jo telegrafik, ku të trajtoheshin juridikisht të gjitha problematikat e çështjes. Në rastin konkret, nuk është

përpara gjësë së gjykuar, pasi proceset gjyqësore nuk janë të njëjta, sikurse kanë arsyetuar gjykatat. Në procesin konkret, palët në gjykim dhe objekti i kërkimeve janë të ndryshme. Për një pasuri mund të ketë disa kërkime dhe procese të pavarura nga njëri-tjetri.

7.5. *E drejta e pronësisë, e garantuar nga neni 41 i Kushtetutës dhe neni 1 i Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së*, pasi sipërfaqja prej 420 m² është shpronësuar nga organet shtetërore pa asnjë vendim dhe pa asnjë shpërblim, ndërsa gjykatat nuk kanë arritur të kuptojnë, analizojnë dhe të marrin një vendim për konstatimin e cenimit të kësaj të drejte kushtetuese të kërkueses.

III

Vlerësimi i Kolegjit

A. Për legjitimitimin e kërkueses

8. Çështja e legjitimitimit (*locus standi*) është një ndër aspektet kryesore që lidhet me nisjen e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pikat 1, shkronja “i” dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të ligjit nr. 8577/2000, çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike, mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë kriteret kumulative të nenit 71/a të ligjit nr. 8577/2000, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësuar në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale dhe mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur.

9. Në këtë këndvështrim, Kolegji vlerëson se kërkuesja, si individ, legjitimohet *ratione personae*, në kuptim të neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pika 1, shkronja “i” të Kushtetutës, sepse është palë në çështjen objekt të ankimit kushtetues individual, për rrjedhojë ka interes të drejtpërdrejtë për vënien në lëvizje të këtij gjykimi kushtetues.

10. Në lidhje me kriterin e *shterimit të mjeteve juridike efektive*, në kuptim të nenit 131, pika 1, shkronja “f”, të Kushtetutës, kërkuesja i është drejtuar Gjykatës me ankim kushtetues individual pas përfundimit të procesit gjyqësor në të tria shkallët e gjyqësorit të zakonshëm dhe pasi ka shteruar në formë e substancë mjetet e zakonshme të ankimit ndaj vendimeve të gjykatave më të ulëta. Për rrjedhojë, Kolegji vlerëson se ajo nuk ka mjet tjetër juridik në dispozicion për mbrojtjen e të drejtave të tij kushtetuese përveç paraqitjes së ankimit kushtetues

individual (*shih vendimet nr. 24, datë 11.10.2022; nr. 35, datë 01.11.2021; nr. 33, datë 01.11.2021 të Gjykatës Kushtetuese*).

11. Në lidhje me legjitimimin *ratione temporis*, bazuar në nenin 71/a, pika 1, shkronja “b”, të ligjit nr. 8577/2000, afati për paraqitjen e ankimit kushtetues individual është 4 muaj nga konstatimi i cenimit të së drejtës. Kolegji konstaton se vendimi më i fundit në kohë i kundërshtuar nga kërkuesja, ai i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, mban datën 22.12.2023, ndërsa kërkesa është paraqitur në këtë Gjykatë nëpërmjet shërbimit postar në datën 22.04.2024, pra brenda afatit ligjor 4-mujor.

12. Në drejtim të legjitimitetit *ratione materiae*, Kolegji vëren se kërkuesja ka pretenduar se gjatë procesit gjyqësor i është cenuar drejta e aksesit, parimi i paanshmërisë, parimi i barazisë së armëve dhe kontradiktoritetit, standardi i arsytimit të vendimit gjyqësor dhe e drejta e pronësisë.

13. Kolegji, duke mbajtur në konsideratë se argumentet lidhen me procesin gjyqësor të zhvilluar ndaj kërkueses, çmon t’i analizojë pretendimet e paraqitura në këndvështrim të neneve 41 dhe 42 të Kushtetutës, sipas të cilave prona nuk mund të cenohet pa një proces të rregullt ligjor dhe se kushdo, për mbrojtjen e së drejtës kushtetuese të pronës, ka të drejtën e një gjykimi të drejtë. Në vijim, Kolegji vlerëson se argumentet e parashtruara në mbështetje të pretendimeve në thelb kanë të bëjmë me të drejtën e aksesit të lidhur standardin e arsytimit të vendimit gjyqësor, të garantuara në nenin 42 të Kushtetutës, të cilat hyjnë në juridiksionin kushtetues.

B. Për pretendimin e cenimit të së drejtës së aksesit të lidhur me standardin e arsytimit të vendimit gjyqësor

14. Kërkuesja ka pretenduar se Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, megjithëse ishin parashtruar shkelje të ligjit material dhe procedural, nuk i ka përmendur fare ose nuk i ka dhënë përgjigje. Nëse Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë do t’i kishte marrë në shqyrtim të gjitha shkaqet e rekursit dhe do t’i shqyrtonte, do të kishte arritur në një përfundim të ndryshëm. Çështja nuk është gjykuar në themel, por vetëm nga pikëpamja procedurale është arritur në përfundimin se është gjë e gjykuar. Vendimet nuk janë arsyetuar në pajtim me kërkesat procedurale, jurisprudencën e Gjykatës dhe të GJEDNJ-së. Gjykata e Lartë ka bërë një arsyetim telegrafik, pa trajtuar juridikisht të gjitha problematikat e çështjes.

15. Gjykata në jurisprudencën e saj ka theksuar se e drejta e aksesit u garanton subjekteve të cenuara të drejtën t’i drejtohen një gjykate, e cila duhet të dëgjojë pretendimet e

tyre dhe të shpallë një vendim pas një gjykimi të drejtë dhe publik (*shih vendimet nr. 32, datë 03.11.2022; nr. 10, datë 12.04.2022 të Gjykatës Kushtetuese*). Kjo e drejtë e individit nuk përfshin vetëm të drejtën për të filluar një proces, por edhe të drejtën për të pasur, nga ana e gjykatës, një zgjidhje përfundimtare për mosmarrëveshjen objekt gjykimi, pasi aksesimi në gjykatë duhet të jetë substantiv dhe jo thjesht formal (*shih vendimet nr. 32, datë 03.11.2022; nr. 5, datë 22.02.2022; nr. 22, datë 29.04.2021 të Gjykatës Kushtetuese*).

16. Sipas Gjykatës, e drejta për proces të rregullt ligjor përfshin edhe të drejtën për të pasur një vendim gjyqësor të arsyetuar, që i garantohet individit nga nenet 42 dhe 142, pika 1, të Kushtetutës. Arsyetimi i vendimeve është element thelbësor i një vendimi të drejtë. Funkcioni i një vendimi të arsyetuar është t'u tregojë palëve që ato janë dëgjuar, si dhe u jep mundësinë atyre ta kundërshtojnë atë (*shih vendimet nr. 21, datë 26.09.2022; nr. 67, datë 10.11.2017 të Gjykatës Kushtetuese*).

17. Gjykata ka theksuar se shqyrtimi i çështjes nga Gjykata e Lartë në dhomën e këshillimit nuk është vetëm një konstatim formal i paraqitjes së shkaqeve ligjore në rekurs, por konsiston në vlerësimin e këtyre shkaqeve dhe bazueshmërisë së tyre, duke analizuar materialet e dosjes gjyqësore. Nëse Kolegji në dhomën e këshillimit krijon bindjen se shkaqet e ngritura në rekurs janë haptazi të pabazuara, pasi nuk bëjnë pjesë në ato që parashikon dispozita ligjore ose nuk gjejnë mbështetje në aktet e dosjes gjyqësore, atëherë është në funksionin e tij të vendosë, në pajtim me kërkesat ligjore, mospranimin e çështjes për shqyrtim në seancë gjyqësore. Kjo është edhe përgjigjja që Gjykata e Lartë u jep pretendimeve të ngritura në rekurs nga palët (*shih vendimet nr. 5, datë 09.02.2023; nr. 2, datë 11.02.2021; nr. 8, datë 26.02.2015 të Gjykatës Kushtetuese*).

18. Gjithashtu, Gjykata rithekson se është detyrë e gjykatave të juridiksionit të zakonshëm të vlerësojnë faktet dhe provat e administruara, si dhe të interpretojnë ligjin për qëllim të procesit gjyqësor që ato zhvillojnë, ndërsa detyra e kësaj Gjykate është të shqyrtojë dhe vlerësojë nëse gjatë procesit gjyqësor ka pasur shkelje të të drejtave kushtetuese, si dhe nëse zbatimi i ligjit ka qenë eventualisht arbitrar, në kuptimin që të bjerë ndesh haptazi me konceptin e gjykimit të drejtë të përcaktuar në nenin 42 të Kushtetutës (*shih vendimet nr. 33, datë 14.11.2022; nr. 3, datë 23.02.2016; nr. 42, datë 07.07.2014 të Gjykatës Kushtetuese*).

19. Në rastin në shqyrtim, Kolegji vëren se procesi gjyqësor ka nisur pas padisë së paraqitur nga kërkuesja për njohjen e saj si trashëgimtare ligjore e trashëgimlënësit O.P., njohjen e së drejtës për pronësisë, kërkimin, dorëzimin e pasurisë trashëgimore të truallit me sipërfaqe 420 m², deklarimin e pavlefshëm të kontratës së shitblerjes të vitit 1992 (të lidhur

mes shtetasit K.B. dhe Komitetit Ekzekutiv të Rajonit Nr. 1, Tiranë) dhe fshirjen nga regjistri i Zyrës Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme (ZVRPP), Tiranë. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë ka vendosur rrëzimin e saj, pasi përbënte gjë të gjykuar, në aspektin material. Ajo ka arsyetuar se kërkimet rezultojnë të jenë të njëjta me çështjen e shqyrtuar në bazë të padisë së paraqitur nga bashkëpronari tjetër Th. P. (vëllai i kërkueses). Edhe për këtë të fundit, gjykata e rrethit me vendimin nr. 3580/2005 ka vendosur rrëzimin e padisë, pasi kërkuesi ishte pronar legjitim vetëm për sipërfaqen 690 m² të blerë në vitin 1961 nga trashëgimlënësi i tij, në të cilën ka kryer ndërtime për nevojat e strehimit dhe të punës. Fakti që ai rezulton formalisht të jetë pronar në ZVRPP-në, Tiranë për sipërfaqen 1014,8 m² ku përfshihet edhe sipërfaqja objekt konflikti, nuk gëzon mbështetje ligjore, pasi kjo sipërfaqe është regjistruar sipas një vendimi gjyqësor vërtetim fakti, i cili nuk sjell detyrime për të tretët kur vërtetohet pronësia në rrugë të tjera. Gjykata e shkallës së parë ka vijuar në arsyetim se i padituri/shtetasi K.B. është pronar legjitim i sipërfaqes së truallit, mbi të cilin ka ngritur ndërtesën trekatëshe, pasi e ka fituar pronësinë në mënyrë legjitime, duke e blerë nga shteti në vitin 1992, pra gati 3 vjet përpara se paditësi ta regjistronte këtë sipërfaqe në ZVRPP-në, Tiranë sipas vendimit gjyqësor për vërtetim fakti.

20. Ndaj vendimit kërkuësja ka paraqitur ankim në Gjykatën e Apelit Tiranë dhe kjo e fundit, me të njëjtin arsyetim, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të gjykatës së shkallës së parë. Gjykata e apelit, mes të tjerave, ka arsyetuar se vendimi nr. 3580/2005 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë është i detyrueshëm edhe për kërkuesen si bashkëpronare.

21. Pas rekursit të ushtruar nga kërkuësja, Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, në dhomën e këshillimit, me vendimin nr. 00-2023-5459, datë 22.12.2023 ka vendosur mospranimin e rekursi, pasi nuk përmbante shkaqet e parashikuara në nenin 472 të KPC-së. Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë ka arsyetuar se të dyja gjykatat kanë analizuar drejt parimin e gjësë së gjykuar, si një parim i rëndësishëm jo vetëm i procedurës civile, por edhe i procesit të rregullt dhe parimit të sigurisë juridike. Pasuria objekt gjykimi, e cila kërkohet nga ana e kërkueses në cilësinë e trashëgimtares së ish-pronarit/trashëgimlënësit O.P., është kërkuar gjyqësisht nga vëllai i saj në cilësinë e një prej bashkëpronarëve dhe në përfundim është rrëzuar me vendim të formës së prerë.

22. Në analizë të vendimmarrjes së gjykatave të juridiksionit të zakonshëm, në aspektin kushtetues, fillimisht në drejtim të pretendimit për mospasqyrimin e shkaqeve të rekursit në vendimin e Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, Kolegji vëren se kërkuësja nuk ka parashtruar asnjë argument për të konkretizuar pretendimin e saj, për më tepër në pjesën hyrëse të atij

vendimi pasqyrohen të gjitha shkaqet e parashtruara nga ajo në rekurs, të cilat, në mënyrë të përmbledhur, kanë të bëjnë me zbatimin e ligjit nga gjykatat më të ulëta për zgjidhjen e mosmarrëveshjes juridikocivile, me faktin se sipas kërkueses, në rastin konkret, nuk është përpara gjësë së gjykuar, kanë gjetur pasqyrim rrethanat e çështjes, si dhe vlerësimi i Gjykatës së Lartë në vështrim të nenit 472 të KPC-së për natyrën e këtyre shkaqeve, të cilat i ka vlerësuar se nuk e bëjnë të cenueshëm vendimin e gjykatës së apelit. Gjithashtu, vendimi i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë i ka dhënë përgjigje edhe pretendimit thelbësor të kërkueses për vendimmarrjen e gjykatave më të ulëta në drejtim të zgjidhjes së çështjes konkrete.

23. Nën dritën e këtyre rrethanave, Kolegji, duke e vlerësuar çështjen në respektim të së drejtës së aksesit të lidhur me standardin e arsytimit të vendimit, rezulton se Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, në dhomën e këshillimit, edhe pse gjatë shqyrtimit të rekursit sipas procedurës së seleksionimit u ka dhënë përgjigje pretendimeve të paraqitura në rekurs dhe se interpretimi e zbatimi i ligjit nga gjykatat e juridiksionit të zakonshëm, në lidhje me përfundimin e arritur nuk është arbitrar dhe të ketë ndikuar në të drejtat kushtetuese të kërkueses.

24. Për sa më lart, Kolegji vlerëson se pretendimi i kërkueses për cenimin e së drejtës së aksesit të lidhur me standardin e arsytimit të vendimit gjyqësor, është haptazi i pabazuar. Për rrjedhojë, në kushtet kur ndaj kërkueses nuk ka pasur shkelje të së drejtës për proces të rregullt ligjor, edhe pretendimi i saj për cenimin e së drejtës së pronësisë është haptazi i pabazuar.

25. Në përfundim, Kolegji çmon se kërkesa nuk plotëson kriteret ligjore për kalimin e saj për shqyrtim në seancë plenare.

PËR KËTO ARSYE,

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese, në bazë të neneve 31 dhe 31/a, pika 2, shkronja “e”, të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

V E N D O S I:

Moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare.